



**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# EDICION SPECIAL I BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË **KORRUPSIONI, SUNDIMI I LIGJIT DHE INTEGRITETI POLICOR NË KOSOVË**

MARS 2019





EDICION SPECIAL I BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË  
KORRUPSIONI, SUNDIMI I LIGJIT DHE  
INTEGRITETI POLICOR NË KOSOVË

**Botues:** Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Autor:** Plator Avdiu

**Redaktor i brendshëm:** Mentor Vrajolli

Prishtinë

Mars 2019

---

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni në: [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org) ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të marra nga të anketuarit dhe tregojnë mënyrën si i perceptojnë ata institucionet. Ky nuk është vlerësim përfundimtar i punës së institucioneve që janë temë e këtij studimi. Raporti do t'u shërbejë atyre si instrument për të adresuar mangësitë e mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED).

# PËRMBAJTJA

HYRJE	7
GJETJET KRYESORE	8
<b>KAPITULLI 1 - BESUESHMËRIA E PUBLIKUT: MIT APO REALITET?</b>	<b>9</b>
<b>KAPITULLI 2 - KORRUPSIONI: KËRCËNIMI DHE RREZIKU MË I MADH NDAJ SIGURISË KOMBËTARE NË KOSOVË</b>	<b>11</b>
2.1 PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT NË INSTITUCIONET E KOSOVËS	13
2.1.1. Institucionet më të korruptuara në vitin 2018	14
2.1.2. Institucionet më pak të korruptuara në vitin 2018	16
<b>KAPITULLI 3 - PERCEPTIMI I INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS</b>	<b>19</b>
3.1. PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT NË SEKTORËT E POLICISË	20
<b>METODOLOGJIA</b>	<b>22</b>
ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	22

# LISTA E FIGURAVE

Figure 1 - Besueshmëria në institucionet e Kosovës (2018)	9
Figure 2 - Kontakti i drejtpërdrejtë i të anketuarve me institucionet e Kosovës (2018)	10
Figure 3 - Sipas mendimit tuaj, cili është kërcënimi dhe rreziku më i madh ndaj sigurisë në Kosovë (pyetje e hapur, 2018)?	11
Figure 4 - Cilat janë rreziqet më të mëdha ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës (pyetje e hapur, 2018)?	12
Figure 5 - Perceptimi i korrupsionit në institucionet e Kosovës (2018)	13
Figure 6 - Perceptimi i korrupsionit në Gjykata dhe Prokurori sipas rajoneve të Kosovës (2018)	14
Figure 7 - Perceptimi i korrupsionit në Gjykata dhe Prokurori sipas zonave të Kosovës (2018)	15
Figure 8 - Perceptimi i korrupsionit në Gjykata dhe Prokurori sipas përbërjes gjinore të të anketuarve (2018)	15
Figure 9 - Perceptimi i korrupsionit në Gjykata dhe Prokurori sipas përbërjes etnike të të anketuarve (2018)	16
Figure 10 - Perceptimi i korrupsionit në Komuna dhe Policinë e Kosovës sipas rajoneve të Kosovës (2018)	17
Figure 11 - Perceptimi i korrupsionit në Komuna dhe Policinë e Kosovës sipas zonave të Kosovës (2018)	17
Figure 12 - Perceptimi i korrupsionit në Komuna dhe Policinë e Kosovës sipas përbërjes gjinore të të anketuarve (2018)	18
Figure 13 - Perceptimi i korrupsionit në Komuna dhe Policinë e Kosovës sipas përbërjes etnike të të anketuarve (2018)	18
Figure 14 - Perceptimet e të anketuarve se për kë punon Policia e Kosovës (2018)	19
Figure 15 - A keni qenë dëshmitar i ndonjë sjelljeje të pahijshme/shkeljeje të kryer nga policët në Kosovë (2018)?	19
Figure 16 - Nëse përgjigjja në pyetjen e mëparshme është “po”, çfarë lloj sjelljeje të pahijshme kanë kryer policët në Kosovë (pyetje e hapur, 2018)?	20
Figure 17 - Korrupsioni në sektorët e Policisë së Kosovës (2018)	21
Figure 18 - Perceptimi i korrupsionit në sektorët e Policisë së Kosovës sipas rajoneve të Kosovës (2018)	23
Figure 19 - Perceptimi i korrupsionit në sektorët e Policisë së Kosovës sipas zonave të Kosovës (2018)	24
Figure 20 - Perceptimi i korrupsionit në sektorët e Policisë së Kosovës sipas përbërjes gjinore të të anketuarve (2018)	25
Figure 21 - Perceptimi i korrupsionit në sektorët e Policisë së Kosovës sipas përbërjes etnike të të anketuarve (2018)	27
Figure 22 - Ku do ta raportoni së pari sjelljen e pahijshme të policisë (pyetje e hapur, 2018)?	28

---

# HYRJE

---

Ky edicion special i Barometrit Kosovar të Sigurisë zbërthen perceptimin publik në Kosovë ndaj korrupsionit, sundimit të ligjit dhe integritetit policor. Ky raport ofron një interpretim gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm të të dhënave në lidhje me perceptimin e opinionit publik, të bazuara në një grup pyetjesh të paracaktuara për çështjen në fjalë.

Në këtë drejtim, ky raport elaboron perceptimin e të anketuarve të Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2018 ndaj besueshmërisë, kontakteve të drejtpërdrejta dhe pranisë së korrupsionit në këto institucione: Gjykata, Prokurori, Policinë e Kosovës dhe komunat. Në këtë mënyrë, raporti ka matur perceptimet publike mbi këto institucione me qëllim të analizimit të çështjeve më relevante që sfidojnë sundimin e ligjit dhe integritetin e institucioneve të drejtësisë, sigurisë dhe atyre komunale në Kosovë. Ky raport përbëhet nga tre pjesë.

Pjesa e parë prezanton nivelin e besimit të shprehur nga të anketuarit në institucionet përkatëse (institucionet e drejtësisë, sigurisë dhe komunale), si dhe kontaktet e drejtpërdrejta të të anketuarve me këto institucione gjatë vitit 2018. Ngjashëm me vitet e kaluara, institucionet e sigurisë gëzojnë besueshmërinë më të madhe kur rezultatet krahasohen me institucionet e tjera të analizuar në këtë edicion special.

Nga ana tjetër, pjesa e dytë e raportit interpreton kërcënimet dhe rreziqet kyçe ndaj sigurisë në Kosovë. Duke qenë se korrupsioni është renditur si problemi më i madh për sigurinë kombëtare të Kosovës, kjo pjesë përqendrohet në pikëpamjet e të anketuarve ndaj korrupsionit në institucionet kosovare. Përveç interpretimit të përgjithshëm të të dhënave për korrupsion në Gjykata, Prokurori, Policinë e Kosovës dhe komuna, raporti ofron analizën e kryqëzuar të të dhënave për të gjitha institucionet sipas rajonit, zonave rurale/urbane, përkatësisë gjinore dhe etnike të të anketuarve.

Ndërkohë, pjesa e tretë ose e fundit e raportit ofron një interpretim të hollësishëm të pyetjeve të hapura dhe të mbyllura të anketës së vitit 2018 të Barometrit Kosovar të Sigurisë për çështjet kryesore që dëmtojnë integritetin e policisë në Kosovë. Rrjedhimisht, rezultatet që paraqesin mendimet e të anketuarve për korrupsionin në kuadër të sektorëve të Policisë së Kosovës, ofrojnë një pasqyrë më të qartë mbi atë se cilët sektorë të Policisë së Kosovës janë më shumë dhe më pak të korruptuar. Për më tepër, analiza e të dhënave përmes rezultateve të kryqëzuara (bazuar në rajone, zona, përkatësi gjinore dhe etnike) siguron një shtjellim shterues të qëndrimeve të të anketuarve ndaj korrupsionit në Policinë e Kosovës.

Marrë parasysh se anketa e Barometrit Kosovar të Sigurisë u realizua në gjysmën e dytë të vitit 2018 (shtator-tetor 2018), ky raport nuk i pasqyron disa nga zhvillimet që kanë ndodhur nga prej nëntorit të vitit 2018 deri në mars të vitit 2019.

# GJETJET KRYESORE

Ky edicion special i Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2018 analizon perceptimet e të anketuarve ndaj institucioneve të përzgjedhura që merren me sigurinë, sundimin e ligjit dhe nivelin e qeverisjes komunale. Anketa u zhvillua nga 29 shtatori deri më 5 tetor 2018, prandaj zhvillimet që kanë ndodhur nga periudha prej nëntorit të vitit 2018 deri në mars të vitit 2019 nuk pasqyrohen në raport, për shkak të faktit se raportit analizon vetëm të dhënat kuantitative të perceptimeve të publikut ndaj institucioneve dhe çështjeve relevante të përmes Barometrit Kosovar të Sigurisë.

Gjetjet kyçe të raportit janë renditur në vijim:

## Besueshmëria e publikut ndaj institucioneve të Kosovës:

- Policia e Kosovës është institucioni më i besuar i sundimit të ligjit në Kosovë në vitin 2018, në krahasim me gjykatat, prokuroritë dhe komunat. Rreth 61 për qind e të anketuarve kanë besim në Policinë e Kosovës. Kjo e fundit gëzonte një nivel të ngjashëm besimi edhe në vitin 2017.
- Më pak se gjysma e të anketuarve ose 39 për qind e tyre kanë besim në komunat në Kosovë.
- Megjithatë, institucionet ndaj të cilave të anketuar kanë shprehur më së paku besim në vitin 2018 janë institucionet e drejtësisë - vetëm 32 për qind e të anketuarve kanë besim në Prokurorinë, ndërsa vetëm 27 për qind e tyre u besojnë Gjykatave.

## Kontakti i drejtpërdrejtë i të anketuarve me institucionet e Kosovës:

- Shpeshësinë më të madhe të kontaktit të drejtpërdrejtë të anketuarit e kishin me komunat, me 62 për qind prej tyre që deklaruan se kishin kontakt me to, sesa me Policinë e Kosovës (vetëm 29 për qind) dhe Gjykatat (vetëm 15 për qind).

## Kërcënimi dhe rreziku kyç ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë:

- Sipas opinioneve të të anketuarve, fenomeni i korrupsionit është kërcënimi dhe rreziku më i madh ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë. Shumica e tyre, më saktësisht 89 për qind e të anketuarve, pohuan se korrupsioni është çështja më sfiduese në Kosovë.
- Korrupsioni pasohet nga papunësia (89 për qind) dhe krimi i organizuar (88 për qind) si kërcënimi dhe rreziku i dytë dhe i tretë më i madh ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë. Kur bëhet krahasimi me korrupsionin, vërehet dallim i vogël në përqindje.

## Perceptimi i korrupsionit në institucionet e Kosovës:

- Institucionet e drejtësisë në Kosovë janë më të korruptuarat në vitin 2018, bazuar në rezultatet e Barometrit Kosovar të Sigurisë 2018. Rreth 51 për qind e të anketuarve i perceptojnë ato të korruptuara, ndërsa 49 për qind e të anketuarve konsiderojnë se Prokuroria është e prekur nga korrupsioni.
- Për dallim prej tyre, institucionet më pak të korruptuara janë komunat dhe Policia e Kosovës. Rreth 29 për qind e të anketuarve janë shprehur se ato janë të korruptuara.

## Perceptimi i korrupsionit në kuadër të sektorëve të Policisë së Kosovës:

- Policët e trafikut perceptohen si sektori më i korruptuar në Policinë e Kosovës, me 32 për qind të të anketuarve që e pohojnë këtë. Ndërkohë, policët kufitarë janë në vendin e dytë nga 31 për qind e të anketuarve që i perceptojnë si të korruptuar.
- Nga ana tjetër, sektorët më pak të korruptuar të policisë janë menaxhmenti i policisë me 29 për qind dhe policët që veprojnë në stacionet më të afërta policore me 18 për qind të të anketuarve.

## Perceptimi i integritetit në Policinë e Kosovës:

- Shumica e të anketuarve, më saktësisht 58 për qind e tyre, mendojnë se Policia e Kosovës punon për interesat e qytetarëve, krahasuar me 17 për qind që perceptojnë se ky institucion punon për Qeverinë e Kosovës. Të anketuarit e tjerë mendojnë se Policia e Kosovës punon për partitë politike (11 për qind), klanet (7 për qind) dhe menaxhmentin e policisë (2 për qind).
- Të anketuarit perceptojnë se sjelljet e pahijshme më të shpeshta të kryera nga policët në Kosovë janë shkeljet e rregullave të trafikut me 34 për qind dhe korrupsioni me 17 për qind.
- Në rast të sjelljeve të pahijshme ose shkeljeve të policisë, të anketuarit u përgjigjën se veprimet e tilla do t'i raportonin së pari në Policinë e Kosovës. Rreth 33 për qind e të anketuarve pohuan se adresa e tyre e parë do të ishte policia, ndërsa i dyti në listë për raportimin e sjelljeve të pahijshme të kryera nga policët do të ishte Inspektorati Policor i Kosovës me 14 për qind.
- Institucionet e tjera në të cilat qytetarët do t'i raportonin punonjësit e policisë për sjellje të pahijshme ishin Gjykatat me 4 për qind, mediat me 4 për qind, Prokuroria me 3 për qind dhe Komunat me 2 për qind të të anketuarve.

## BESUESHMËRIA E PUBLIKUT: MIT APO REALITET?

Ky edicion i posaçëm i Barometrit Kosovar të Sigurisë 2018 (BKS) analizon perceptimet e të anketuarve ndaj institucioneve të përzgjedhura që merren me sigurinë, sundimin e ligjit dhe nivelin e qeverisjes komunale. Ngjashëm me vitet e mëparshme, në vitin 2018 Policia e Kosovës (PK) gëzon një shkallë të lartë të besueshmërisë nga publiku, duke ndjekur Forcën e Sigurisë së Kosovës në renditjen si institucioni më i besuar nga të anketuarit në Kosovë në vitin 2018 (gjithsej 78 për qind).<sup>1</sup>

Sidoqoftë, kur krahasohet me Gjykatat, Prokurorinë dhe Komunat, PK-ja perceptohet kryesisht në mënyrë pozitive nga 61.3 për qind e të anketuarve që i besojnë këtij institucioni. Edhe pse PK-ja përballlet me sfida serioze për qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, në aspektin e besueshmërisë nga publiku

këto rezultate e rendisin të parën në raport me institucionet e drejtësisë dhe ato komunale.

Nga ana tjetër, komunat kanë besueshmëri më të ulët nga të anketuarit, duke qenë se më pak se gjysma e tyre, më saktësisht 39.1 për qind e tyre, kanë besim në institucionet komunale në Kosovë. Megjithatë, mes institucioneve të analizuara për këtë edicion special të posaçëm të BKS-së, institucionet e sektorit të drejtësisë në Kosovë kanë besueshmërinë më të ulët nga të anketuarit në vitin 2018. Kur flitet për Prokurorinë, vetëm 31.5 për qind besojnë në prokurorët në Kosovë, ndërsa shkalla e besueshmërisë ndaj Gjykatave është edhe më e ulët - vetëm 27.3 për qind e të anketuarve u besojnë atyre.<sup>2</sup>



### Policia e Kosovës



### Komunat



### Prokuroria



### Gjykatat



Figura 1 - Besueshmëria në institucionet e Kosovës (2018)

1 Marku, D. (2018). Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i Tetë. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 10.

2 Për më shumë detaje lidhur me besueshmërinë e publikut në institucionet e Kosovës gjatë vitit 2018, shih raportin e QKSS-së me titull "Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i Tetë", nëntor 2018.



Edicioni i BKS-së për vitin 2018 përmbante një pyetje specifike nëse të anketuarit kanë pasur kontakte të drejtpërdrejta me institucionet përkatëse, përkatësisht PK-në, komunat dhe Gjykatat. Rezultatet treguan se gjatë vitit 2018, shpeshësinë më të madhe të kontaktit të drejtpërdrejtë të anketuarit e kishin me komunat, gjegjësisht 61.8 për qind e atyre u përgjigjen pozitivisht.

Çuditërisht, numri i atyre që kishin pasur kontakt të drejtpërdrejtë me PK-në në vitin 2018 është dukshëm më

i vogël krahasuar me komunat, pasi vetëm 28.7 për qind e të anketuarve u përgjigjën se kishin pasur kontakt të drejtpërdrejtë me policinë, kurse 71.2 prej tyre nuk kishin pasur asnjë kontakt.

Gjatë shqyrtimit të përgjigjeve të kontaktit të drejtpërdrejtë me gjykatat, rreth 14.8 për qind e të anketuarve kishin kontakt të drejtpërdrejtë me këtë institucion, ndërkohë që rreth 84.7 prej tyre nuk kishin asnjë kontakt të drejtpërdrejtë me gjykatat.




Figura 2 - Kontakti i drejtpërdrejtë i të anketuarve me institucionet e Kosovës (2018)

## KORRUPSIONI: KËRCËNIMI DHE RREZIKU MË I MADH NDAJ SIGURISË KOMBËTARE NË KOSOVË

Të anketuarit u pyetën për çështjet më sfiduese që paraqesin kërcënimet dhe rreziqet më të mëdha për sigurinë e Kosovës. Kjo ishte një pyetje e hapur ku të anketuarit ishin të lirë të shprehnin mendimet e tyre për atë që është kërcënimi dhe rreziku kyç ndaj sigurisë kombëtare brenda vendit. Sipas rezultateve të mëposhtme të Figurës 3, korrupsioni është kërcënimi dhe rreziku më i madh ndaj

sigurisë në Kosovë gjatë vitit 2018, duke u konsideruar si problemi kryesor në vend nga 16 për qind e të anketuarve.

Korrupsioni pasohet nga problemet politike (15.6 për qind), papunësia (14.1 për qind), problemet mes Kosovës dhe Serbisë (9.3 për qind), krimi i organizuar (7 për qind), dhe kërcënime dhe rreziqe të tjera të përmendura në




Figura 3 - Sipas mendimit tuaj, cili është kërcënimi dhe rreziku më i madh ndaj sigurisë në Kosove (pyetje e hapur, 2018)?


mënyrë individuale nga të anketuarit në edicionin e vitit 2018 të BKS-së.

Krahas kësaj, anketa e BKS-së për vitin 2018 ka matur edhe perceptimin e të anketuarve se cilat janë rreziqet më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës përmes një pyetjeje të mbyllur. Ndër opsionet e renditura për këtë pyetje, korrupsioni në Kosovë është rreziku kyç dhe mban vendin e parë në listën e rreziqeve të brendshme që ndikojnë në sigurinë kombëtare të vendit. Shumica dërrmuese e të anketuarve, ose 89.2 për qind e tyre, perceptojnë se korrupsioni është rreziku më i madh i brendshëm në Kosovë.

Pavarësisht se ka dallime të vogla në përqindje, një përqindje e njëjtë e të anketuarve (më saktësisht 89.0 për qind) e kanë renditur sfidën e papunësisë si rrezikun e dytë të

brendshëm ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës. Edhe pse ndryshon lehtë në aspektin e përqindjes, krimi i organizuar perceptohet si rrezik i brendshëm nga 88.2 për qind e të anketuarve. Rreziqet e tjera janë ndarja e Kosovës me 84.3 për qind, autonomia territoriale për serbët e Kosovës në veri me 82.3 për qind, përplasjet politike në Kosovë me 75.9 për qind, ekstremizmi i dhunshëm me 70 për qind dhe fatkeqësitë natyrore me 60.7 për qind të të anketuarve.

Të përmbledhura, sfidat (rreziqet) kryesore të brendshme ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës janë korrupsioni, papunësia dhe krimi i organizuar, të cilat janë të lidhura me sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë, integritetin institucional dhe zhvillimin ekonomik të vendit.



**Figura 4 - Cilat janë rreziqet më të mëdha ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës (pyetje e hapur, 2018)?**

## 2.1. Perceptimi i korrupsionit në institucionet e Kosovës

Të dhënat kuantitative të grumbulluara nga përgjigjet e dhëna nga të anketuarit në kuadër të BKS-së në vitin 2018 dëshmojnë se institucionet e drejtësisë janë sektori më i korruptuar në Kosovë. Në këtë drejtim, Gjykatat kanë rezultuar të jenë institucioni më i korruptuar në Kosovë, marrë parasysh se më shumë se gjysma e të anketuarve ose 50.8 për qind e tyre, kanë deklaruar se janë të

korruptuara. Ato ndiqen nga Prokuroria, me 49.3 për qind të të anketuarve që ndajnë perceptimin se ky institucion është i korruptuar. Kjo përputhet edhe me besueshmërinë e publikut meqë këto institucione kanë besimin më të ulët nga të anketuarit.

Nga ana tjetër, sipas përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit, institucionet më pak të korruptuara në Kosovë janë komunat me 29 për qind dhe Policia e Kosovës me 29 për qind.




Figura 5 - Perceptimi i korrupsionit në institucionet e Kosovës (2018)

### 2.1.1 Institucionet më të korruptuara në vitin 2018

Kur zbërthehen rezultatet për korrupsion në Gjykata sipas tetë rajoneve individuale të Kosovës, kuptohet se numri më i lartë i të anketuarve që perceptojnë se Gjykatat janë të korruptuara janë nga rajonet e Gjakovës (57.1 për qind) dhe Pejës (56.7 për qind). Ato ndiqen nga rajonet e Prishtinës (53.8 për qind), Ferizajt (53.4 për qind), Mitrovicës së Veriut (51.7 për qind) dhe rajonet e tjera nën 50 për qind.

Kur shqyrtohet prania e korrupsionit në Prokurori, rreth 55.2 për qind e të anketuarve nga rajoni i Prishtinës dhe 55.1 për qind nga rajoni i Gjakovës besojnë se prokurorët janë të korruptuar në Kosovë, pasuar nga rajonet e Pejës (53 për qind), Mitrovicës së Veriut (51.7 për qind) Ferizajt (48.1 për qind) dhe rajonet e tjera përkatëse të ilustruara në figurën e mëposhtme.





Figura 6 - Perceptimi i korrupsionit në Gjykata dhe Prokurori sipas rajoneve të Kosovës (2018)


Në pyetjen për korrupsionin në Gjykata, shfaqen dallime të vogla në perceptimin e të anketuarve nga zonat rurale dhe urbane. Krahasuar me zonat rurale, zonat urbane kanë tendencë të besojnë se gjykatat janë më të korruptuara (nga 51.9 për qind në zonat urbane në 50.1 për qind në zonat rurale).

Sidoqoftë, ndryshon këndvështrimi për perceptimin e korrupsionit në Prokurori. Të anketuarit në zonat rurale (rreth 50.1 për qind) kanë ndarë pikëpamjet e tyre se Prokuroria është më e korruptuar në krahasim me 48.7 për qind të të anketuarve në zona urbane.



**Figura 7 - Perceptimi i korrupsionit në Gjykata dhe Prokurori sipas zonave të Kosovës (2018)**

Sa i përket përkatësisë gjinore, në krahasim me të anketuarat femra, meshkujt në Kosovë kanë tendencë të perceptojnë se institucionet e drejtësisë (Gjykatat dhe Prokuroria) janë më të korruptuara.




**Figura 8 - Perceptimi i korrupsionit në Gjykata dhe Prokurori sipas përbërjes gjinore të të anketuarve (2018)**

Analiza e të dhënave sipas përkatësisë etnike pasqyron në mënyrë më të plotë të rezultateve mbi korrupsionin në sektorin e drejtësisë në Kosovë. Prandaj, vërehet se të anketuarit nga komuniteti serb i Kosovës perceptojnë se Gjykatat dhe Prokuroritë janë më të korruptuara sesa të anketuarit shqiptarë si popullata shumicë dhe komunitetet tjera jo-shumicë, duke përfshirë komunitetet turke, boshnjake, goranë, romë, ashkali dhe egjiptase.

Në këtë drejtim, rreth 55.8 për qind e komunitetit serb të Kosovës besojnë se Gjykatat janë të korruptuara, në krahasim me 50.3 për qind të të anketuarve shqiptarë të Kosovës si popullatë shumicë që e kanë shprehur mendim të ngjashëm. Përveç kësaj, rreth 50 për qind e komuniteteve të tjera perceptojnë se Gjykatat janë të prekura nga korrupsioni.

Rezultate të ngjashme dalin edhe në lidhje me Prokurorinë. Rreth 62.8 për qind e të anketuarve nga komuniteti i serbëve të Kosovës perceptojnë se Prokuroria është e korruptuar, ndërsa 48.2 për qind e të anketuarve në radhët e shqiptarëve të Kosovës perceptojnë se Prokuroria është e korruptuar. Nga pikëpamja statistikore, rreth 45.5 për qind e të anketuarve që përfaqësojnë komunitetet e tjera ndajnë mendimin e tyre se Prokuroria është e korruptuar.




**Figura 9 - Perceptimi i korrupsionit në Gjykata dhe Prokurori sipas përbërjes etnike të të anketuarve (2018)**

## 2.1.2 Institucionet më pak të korruptuara në vitin 2018

Komunat dhe PK-ja ndajnë përqindjen e njëjtë të perceptimeve të korrupsionit (29 për qind e të anketuarve i perceptojnë si të korruptuara), çka i bën institucionet më pak të korruptuara në Kosovë gjatë vitit 2018 krahasuar me Gjykatat dhe Prokurorinë. Në mënyrë të ngjashme, kjo pjesë e raportit ofron të dhëna sipas rajoneve, zonave, përkatësisë gjinore dhe etnike të të anketuarve.

Sa u përket rajoneve, të anketuarit nga rajoni i Pejës me 44 për qind dhe ata të Gjakovës me 40.8 për qind, mendojnë se komunat janë institucionet më të korruptuara, pasur nga Mitrovica e Veriut (31 për qind), Gjilani (28.2 për qind), Ferizaj (27.8 për qind) dhe Prishtina (26 për qind). Komunat më pak të korruptuara të renditura nga të anketuarit i përkasin rajonit të Prizrenit me 24.9 për qind dhe të Mitrovicës me vetëm 22.6 për qind që i perceptojnë si të korruptuara.


Nga ana tjetër, sa i përket korrupsionit në PK, ndryshe nga rajonet e tjera, 75.9 për qind e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut pohuan se PK-ja është e prekur nga korrupsioni. Për më tepër, të anketuarit e tjerë që e perceptojnë policinë si të korruptuar janë nga rajonet e Gjakovës (38.8 për qind), Pejës (32.8 për qind), Ferizajt (29.3 për qind) dhe Gjilanit (25.8 për qind). Ndërkohë, të anketuarit në rajonet e Prishtinës (24.7 për qind), Prizrenit (24.9 për qind) dhe Mitrovicës (21.0 për qind) perceptojnë se PK-ja është më pak e korruptuar.



**Figura 10 - Perceptimi i korrupsionit në Komuna dhe Policinë e Kosovës sipas rajoneve të Kosovës (2018)**

Kur shqyrtohet korrupsioni në komuna sipas zonave rurale dhe urbane, pothuajse nuk ka dallime në pikëpamjet e të anketuarve. Rreth 29 për qind e të anketuarve, si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane, perceptojnë se komunat janë të korruptuara.


Kur flitet për PK-në, ka dallime të vogla në perceptimin e pranisë së korrupsionit në mesin e të anketuarve nga zonat rurale dhe urbane. Në fakt, zonat rurale kanë tendencë të besojnë se PK-ja është më e korruptuar, me 28.9 për qind, krahasuar me zonat urbane me 27.8 për qind.



**Figura 11 - Perceptimi i korrupsionit në Komuna dhe Policinë e Kosovës sipas zonave të Kosovës (2018)**

Sa i përket përbërjes gjinore të të anketuarve, 30.1 për qind e meshkujve në Kosovë besojnë se komunat janë më të korruptuara, krahasuar me 28.3 për qind të femrave të anketuara. Nga ana tjetër, evidentohen dallime të vogla në lidhje me korrupsionin në PK; rreth 29 për qind e të anketuarve meshkuj dhe të anketuarve femra perceptojnë policinë si të korruptuar.





**Figura 12 - Perceptimi i korrupsionit në Komuna dhe Policinë e Kosovës sipas përbërjes gjinore të të anketuarve (2018)**


Figura e mëposhtme tregon se komuniteti serb i Kosovës ka më shumë prirje që t'i perceptojë komunat dhe Policinë e Kosovës si institucione të korrumpuara, ndryshe nga shqiptarët e Kosovës si popullsi shumicë dhe komunitetet e tjera jo-shumicë.

Kështu, rreth 38.4 për qind e serbëve të Kosovës mendojnë se komunat janë të korrumpuara, krahasuar me 28.4 për qind të shqiptarëve të Kosovës dhe 22.7 për qind të komuniteteve të tjera.

Sa i përket policisë, numri i serbëve të Kosovës që e perceptojnë si të korrumpuar është dukshëm më i lartë se për komunat - rreth 73.3 për qind e të anketuarve në këtë komunitet ndajnë mendimin se PK-ja është institucion i korrumpuar, duke shënuar kështu perceptimet më negative të shprehura nga ky komunitet ndaj çfarëdo institucioni kosovar sa i përket korrupsionit. Edhe pse institucionet e sektorit të drejtësisë në Kosovë (Gjykatat dhe Prokuroria)

janë më të korrumpuara sesa PK-ja, të paktën sipas statistikave, serbët e Kosovës nuk kanë pasur perceptime kaq të lartë negativ ndaj tyre kur krahasohen me PK-në.

Përkundrazi, shqiptarët e Kosovës kanë perceptime mjaft të ndryshme për korrupsionin në PK - rreth 25.2 për qind e tyre e shohin PK-në si të korrumpuar, ndërsa 29.4 për qind e komuniteteve të tjera e perceptojnë si të prekur nga korrupsioni.



**Figura 13 - Perceptimi i korrupsionit në Komuna dhe Policinë e Kosovës sipas përbërjes etnike të të anketuarve (2018)**

## PERCEPTIMI I INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS

Përveç rezultateve që e rendisin PK-në si një nga institucionet më të besuara, të anketuarit në Kosovë mendojnë po ashtu se PK-ja i shërben më shumë interesit publik sesa palëve të tjera, siç janë Qeveria e Kosovës, partitë politike, klanet apo menaxhmenti i lartë i policisë.

Në këtë drejtim, shumica e konsiderueshme e të anketuarve, ose 57.8 për qind e tyre, ndanë mendimet se PK-ja punon për qytetarët. Përqindja e atyre që perceptojnë se PK-ja punon për interesat e Qeverisë është dukshëm më e vogël - 16.9 për qind, ndërkohë që 11.4 për qind e të anketuarve mendojnë se policia punon për partitë politike të Kosovës. Kur llogariten dy përqindjet e fundit, kjo do të thotë se rreth 28 për qind e të anketuarve kanë perceptime se PK-ja punon për aktorët politikë, qofshin ata Qeveria apo partitë politike.

Nga ana tjetër, rreth 7.4 për qind e të anketuarve u përgjigjën se PK-ja punon për klanet, kurse 2 për qind për menaxhmentin e policisë.




Figura 14 - Perceptimet e të anketuarve se për kë punon Policia e Kosovës (2018)

Të anketuarit u pyetën nëse kanë qenë dëshmitar të ndonjë sjellje të pahijshme ose shkelje të kryer nga policët në Kosovë gjatë vitit 2018.

Rrjedhimisht, vetëm 134 të anketuar, ose 12.5 për qind e tyre, pranuan se kanë qenë dëshmitarë të shkeljeve të shkaktuara nga policët në Kosovë. Për dallim, shumica e të anketuarve, më saktësisht 895 prej tyre ose 83.7 për qind, deklaruan se nuk kanë qenë dëshmitar të ndonjë sjellje të pahijshme/shkelje nga policët në Kosovë.

Dyzet të anketuarit e tjerë ose 3.7 për qind e tyre, nuk e dinin/nuk u përgjigjen në këtë pyetje të veçantë.





Figura 15 - A keni qenë dëshmitar i ndonjë sjelljeje të pahijshme/shkeljeje të kryer nga policët në Kosovë (2018)?

Të anketuarit që u përgjigjën se kanë qenë dëshmitarë të sjelljeve të pahijshme/shkeljeve të kryera nga policët në Kosovë, kishin edhe mundësi të përmendin në mënyrë deklarative sjelljet e pahijshme në të cilat ishin përfshirë policët.

Shkeljet më të zakonshme të listuar nga të anketuarit janë ato të rregullave të trafikut nga policët në situata të ndryshme. Në lidhje me këtë, 38 të anketuar ose 33.9 për qind e tyre, deklaruan se PK-ja ka shkelur rregullat e trafikut, ndërsa 19 të anketuar ose 17 për qind mendojnë se policët kanë qenë subjekt i korrupsionit, respektivisht ryshfetit. Një pjesë tjetër

prej 17 për qind të të anketuarve ndajnë mendimet e tyre se PK-ja ka qenë e padrejtë me qytetarët në trafik.

Sjelljet e tjera pahijshme nga ana e policëve sipas të anketuarve përfshijnë nepotizmin (3.6 për qind), policët nuk janë të sjellshëm (2.7 për qind) dhe përdorimin e forcës nga PK-ja kundër qytetarëve (1.8 për qind). Kurse, sjelljet e tjera të pahijshme të shprehura në përqindje më të vogël se 1 për qind janë grupuar në sjellje të tjera të pahijshme (18 për qind në total).



**Figura 16 - Nëse përgjigja në pyetjen e mëparshme është "po", çfarë lloj sjelljeje të pahijshme kanë kryer policët në Kosovë (pyetje e hapur, 2018)?**

### 3.1. Perceptimi i korrupsionit në sektorët e policisë

Ky edicion special synon të zbërthejë qëndrimet dhe perceptimet e të anketuarve në lidhje me integritetin e Policisë së Kosovës, përfshirë mendimet e tyre në lidhje me korrupsionin në kuadër të PK-së. Prandaj, edicioni i vitit 2018 i BKS-së përfshiu një sërë pyetjesh përmes të cilave të anketuarit u përgjigjën për nivelin e korrupsionit në sektorët përkatës të PK-së, duke përfshirë Policinë e Trafikut, Policinë Kufitare, menaxhmentin e policisë dhe policët e stacionit më

të afërt policor në komunat përkatëse ku janë intervistuar të anketuarit.

Sipas rezultateve, Policia e Trafikut është sektori më i korruptuar në PK, me 31.8 për qind të të anketuarve që ndajnë qëndrime të tilla, e pasuar nga Policia Kufitare, të cilën 31.1 për qind e të anketuarve e konsiderojnë si të korruptuar. Për dallim prej tyre, menaxhmenti i policisë konsiderohet të jetë më pak i korruptuar (28.7 për qind e perceptojnë si të korruptuar), ndërsa më pak të korruptuar janë policët në stacionin më të afërt policor me vetëm 18.5 për qind të të anketuarve që deklarojnë se janë të korruptuar.




Figura 17 - Korrupsioni në sektorët e Policisë së Kosovës (2018)

Sa i përket rajoneve të Kosovës në lidhje me perceptimin e korrupsionit në Policinë e Trafikut, 75.9 për qind e të anketuarve nga rajoni i Mitrovicës së Veriut mendojnë se policët e trafikut janë më të korruptuarit, pasuar nga Gjakova (40.8 për qind), Ferizaj (32.6 për qind), Gjilani (32.3 për qind), Prishtina (31.9 për qind) dhe Prizreni (28.6 për qind). Ndërkohë, të anketuarit që perceptonin se policët e trafikut janë më pak të korruptuar i përkasin rajoneve të Pejës me 25.4 për qind dhe Mitrovicës me 21.8 për qind.

Nga ana tjetër, Policia Kufitare konsiderohet e korruptuar nga shumica e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut (89.7 për qind në total). Kjo mund t'i atribuohet faktit se ky rajon është i banuar kryesisht nga komuniteti serb i Kosovës, i cili nuk ka besim në institucionet e Kosovës në përgjithësi, duke përfshirë edhe PK-në. Ndërkohë, ata pasohen nga të anketuarit e rajonit të Gjakovës me 38.8 për qind që i konsiderojnë policët kufitarë si të korruptuar, ndërsa rajonet e tjera janë në përqindje më të vogla, siç janë Gjilani (33.1 për qind), Ferizaj (31.6 për qind), Mitrovica (30.6 për qind),

Peja (26.9 për qind), Prizreni (27 për qind) dhe Prishtina (24.8 për qind).

Menaxhmenti i policisë perceptohet më pak i korruptuar sesa policët kufitarë dhe të trafikut. Pavarësisht se ky sektor i policisë është më pak i korruptuar, të anketuarit e rajoneve të Mitrovicës së Veriut me 75.9 për qind dhe të Gjakovës me 40.8 për qind, i konsiderojnë më të korruptuar sesa rajonet e tjera. Në fakt, përqindja e gjashtë rajoneve të mbetura shkon nga 28 në 23 për qind të të anketuarve që e konsiderojnë menaxhmentin e policisë si të korruptuar.

Sipas rezultateve të anketës, sektori më pak i korruptuar në kuadër PK-së konsiderohen policët që punojnë në stacionin më të afërt policor. Ngjashëm me rezultatet e mëparshme, 62.1 për qind e të anketuarve nga rajoni i Mitrovicës së Veriut dhe 24.5 për qind nga rajoni i Gjakovës i perceptojnë stacionet më të afërta policore si të korruptuara. Ata pasohen nga rajone të tjera që i perceptojnë dukshëm më pak të korruptuar nga 21 deri në 15 për qind.




Figura 18 - Perceptimi i korrupsionit në sektorët e Policisë së Kosovës sipas rajoneve të Kosovës (2018)

Kur i zbërthejmë qëndrimet e të anketuarve rreth pranisë së korrupsionit në Policinë e Trafikut sipas zonave rurale/urbane, hasim mendim të përbashkët; rreth 31 për qind e të anketuarve në secilën zonë e konsiderojnë Policinë e Trafikut si të korruptuar. Megjithatë, policët kufitarë perceptohen si më të korruptuar nga të anketuarit në zonat urbane, me 33.3 për qind, sesa në zonat rurale me 27.2 për qind.

Kur flitet për korrupsionin në menaxhmentin e Policisë, të anketuarit në zonat urbane (30.6 për qind e konsiderojnë të korruptuar) kanë shprehur qëndrime të ngjashme si

për Policinë Kufitare, duke e konsideruar këtë sektor më të korruptuar krahasuar me zonat rurale (25 për qind e konsiderojnë të korruptuar).

Në krahasim me rezultatet e mëparshme, të anketuarit në zonat rurale (18 për qind) i perceptojnë policët në stacionet më të afërta policore si më të korruptuar sesa të anketuarit në zonat urbane (17.3 për qind). Megjithatë, ekziston një dallim i ngushtë në përqindje ndërmjet zonave rurale dhe urbane në këtë rast.





Figura 19 - Perceptimi i korrupsionit në sektorët e Policisë së Kosovës sipas zonave të Kosovës (2018)

Sa i përket perceptimit të korrupsionit tek policët e trafikut, të anketuarat femra kanë më shumë perceptime negative ndaj tyre, me 33.4 për qind që i konsiderojnë si të korrumpuar, krahasuar me 30.1 për qind të meshkujve në total.

Kur shqyrtohen policët kufitarë, meshkujt dhe femrat në Kosovë ndajnë të njëjtat perceptime rreth korrupsionit në këtë sektor të policisë me 31 për qind për secilin prej tyre.

Nga ana tjetër, menaxhmenti i policisë shihet si më i korrumpuar nga meshkujt (30.6 për qind) sesa nga femrat (27.4 për qind) në Kosovë.

Përveç kësaj, meshkujt kanë tendencë të kenë më shumë qëndrime negative ndaj policëve që punojnë në stacionet e tyre më të afërta policore, me 19.9 për qind që i konsiderojnë si të korrumpuar, në krahasim me 17.5 për qind të femrave që i perceptojnë si të korrumpuar.



**Figura 20 - Perceptimi i korrupsionit në sektorët e Policisë së Kosovës sipas përbërjes gjinore të të anketuarve (2018)**



Kur rezultatet zbërthehen sipas përbërjes etnike të të anketuarve, kuptohet se ndryshe nga shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet e tjera jo-shumicë në Kosovë, pjesa dërrmuese e komunitetit serb të Kosovës i percepton sektorët përkatës të PK-së si më të korruptuar.

Kështu, rreth 72.1 për qind e serbëve të Kosovës mendojnë se policët e trafikut janë të korruptuar, krahasuar me 28.6 për qind të shqiptarëve të Kosovës dhe 9.1 për qind të komuniteteve të tjera.

Ndërkohë, policët kufitarë konsiderohen edhe më të korruptuar sesa oficerët e policisë së trafikut nga të anketuarit e komunitetit serb të Kosovës. Më saktësisht, rreth 77.9 për qind e tyre e perceptojnë Policinë Kufitare si të korruptuar, gjë që është dallim i thellë kur krahasohet me qëndrimet e shqiptarëve të Kosovës (27.5 për qind) dhe të komuniteteve


të tjera (9.1 për qind) në lidhje me korrupsionin në kuadër të Policisë Kufitare.

Nga ana tjetër, menaxhmenti i policisë perceptohet si i korruptuar nga 68.6 për qind e serbëve të Kosovës, 25.6 për qind e shqiptarëve të Kosovës dhe 9.1 për qind e komuniteteve të tjera.


Siç tregojnë rezultatet, sektori policor më pak i korruptuar janë policët që punojnë në stacionet më të afërta policore. Megjithatë, kjo nuk vlen për komunitetin serb të Kosovës kur rezultatet krahasohen me qëndrimet e të anketuarve me përkatësi tjetër etnike. Kështu, rreth 54.1 për qind e të anketuarve nga komuniteti i serbëve të Kosovës ndajnë mendime se policët e stacionit më të afërt policor janë të korruptuar, krahasuar me 15.6 për qind të shqiptarëve të Kosovës dhe 9.1 për qind të komuniteteve të tjera.




### Policia e Trafikut



### Menaxhmenti i policisë



### Policia Kufitare



### Stacioni më i afërt policor




Figura 21 - Perceptimi i korrupsionit në sektorët e Policisë së Kosovës sipas përbërjes etnike të të anketuarve (2018)

Të anketuarve iu ofrua mundësia të zgjedhin se ku do të raportojnë së pari në rast se kanë qenë dëshmitarë për sjellje të pahijshme të kryera nga policët në Kosovë. Si rrjedhojë, PK-ja do të ishte adresa e parë ku qytetarët raportojnë sjellje të pahijshme që përfshijnë punonjësit e policisë, me 32.8 për qind të të anketuarve që ndajnë këtë perceptim, krahasuar me 13.9 për qind të atyre që e vendosën Inspektoratin Policor të Kosovës si institucioni i dytë për të raportuar sjelljet e pahijshme të policisë. Institucionet e tjera në të cilat qytetarët do t'i raportonin punonjësit e policisë për sjellje të pahijshme ishin Gjykatat me 8.1 për qind, mediat me 3.9 për qind, Prokuroria me 2,6 për qind, dhe komunat me 2.2 për qind të të anketuarve. Ndërsa, institucionet e tjera, siç është Institucioni i Avokatit të Popullit, familja, OJQ-të, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia Kundër Korrupsionit, gëzojnë besim shumë të ulët nga qytetarët për raportimin e sjelljeve të pahijshme të kryera nga policët në Kosovë.

Është e rëndësishme të theksohet se të anketuarit ende nuk e perceptojnë Prokurorinë e Kosovës si një institucion kompetent për raportimin e sjelljeve të pahijshme të policisë që mund të çojnë në korrupsion dhe veprimeve të tjera të mundshme penale ku është e përfshirë PK-ja. Kjo mund t'i atribuohet veçanërisht nivelit të ulët të besueshmërisë së publikut ndaj Prokurorisë.

Nga ana tjetër, rreth 7.7 për qind e të anketuarve nuk do t'i raportonin sjelljet e pahijshme të policisë, pasi nuk besonin se institucionet përgjegjëse do të reagonin. Kurse, një pjesë tjetër prej 0.6 për qind të të anketuarve do të ndiheshin të frikësuar, të pasigurt ose të pambrojtur po t'i raportonin sjelljet e pahijshme e policisë në cilindo institucion/agjenci.




Figura 22 - Ku do ta raportonit së pari sjelljen e pahijshme të policisë (pyetje e hapur, 2018)?

---

# METODOLOGJIA

## ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

---



Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i posaçëm i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), i themeluar në shtator të vitit 2012. Fokusi kryesor i tij është matja e besueshmërisë së publikut ndaj institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe atyre qendrore në Kosovë, si dhe matja e perceptimit të qytetarëve për kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë.

BKS-ja është punimi i parë dhe më i madh i këtij lloji i projektuar, zbatuar dhe komunikuar nga një qendër studimore lokale në Kosovë. Veçantia e BKS-së në Kosovë është neutraliteti i saj politik. Si qendër studimore e pavarur, QKSS-ja nuk ka kufizime politike në komunikimin e ndonjë prej gjetjeve dhe mesazheve të anketës.

BKS-ja kombinon metoda kuantitative dhe kualitative që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat mblidhen përmes intervistave ballë për ballë me të anketuarit e përzgjedhur në formë të rastësishme në të gjithë Kosovën nga hulumtuesit e QKSS-së në terren. Pyetësi i BKS-së përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura që i lejojnë të anketuarve të shprehin mendimet e tyre pa opsione të paracaktuara.

Mostrimi, pilotimi dhe intervistat janë realizuar nga 28 hulumtues në terren të ekipeve të QKSS-së. Mostra kombëtare nga e cila u hartua hulumtimi paraqet 1,085 ekonomi familjare, pas mostrimit përfaqësues të popullsisë mbi 18 vjeç në Kosovë.

Përkatësia etnike e të anketuarve ishte 90% shqiptarë të Kosovës, 8% serbë të Kosovës dhe 2% të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptas, goranë, kroatë dhe malazezë), duke pasqyruar përbërjen etnike të Kosovës.



Korniza e mostrës u bazua në zonat e kodit telefonik dhe si të tilla përfshihen 8 rajonet e mëposhtme: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Mitrovicë të Veriut.

Faza e parë e grumbullimit gjeografik u bazua në Raportin e Regjistrimit të Kosovës të vitit 2012. Faza e dytë përfshiu grupimin e mostrave sipas zonës së komunës me një mostër të shtresuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit përdori metodën e mostrës së rastësishme duke përdorur metodën e datëlindjes më të afërt.


Marrja e mostrave të rastit siguron që çdo banor në Kosovë ka probabilitet të barabartë për të qenë i zgjedhur për një intervistë. Duke pasur parasysh mostrën e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë prirjet në qëndrimet

dhe perceptimet në mesin e të gjithë popullsisë së rritur në Kosovë në përgjithësi. Marzhi i gabimit është 3% me një interval besueshmërie prej 95%.


Para fillimit të punës në terren u krye një intervistë pilot në mes të shtatorit 2018 për të testuar realizueshmërinë e pyetësorit. Më pas, ekipi hulumtues raportoi se intervista pilot ishte e suksesshme dhe nuk kishte probleme me instrumentin pilot. Të gjitha intervistat u kryen nga 29 shtatori deri më 5 tetor 2018. Për më tepër, përpunimi dhe analiza e të dhënave u realizua duke përdorur softuerin SPSS.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informatave të mbledhura nga të anketuarit dhe demonstronjë mënyrën si ata i perceptojnë institucionet kosovare.

#### Të anketuarit sipas gjinisë



#### Të anketuarit sipas zonave



Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)

Avdiu, Plator

Edicion special i barometrit kosovar të sigurisë : korrupsioni, sundimi i ligjit dhe integriteti policor në Kosovë / Plator Avdiu. – Prishtinë : QKSS, 2019. – 27 f. ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-679-92-3**

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

ISBN 978-9951-679-92-3



9 789951 679923